



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:169062

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05856444

**P.nr.333/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunatoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit P... H.. nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.794/2024 të datës 07.06.2024, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrit ndëshkimor, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftuar për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 25.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrit ndëshkimor me shenjë PP.II.nr. 794/2024 të datës 07.06.2024, andaj kjo gjykatë jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**Ndaj të pandehurit: P... H,,,**, nga babai R..., i lindur me datë me vendbanim në rrugën "....", në Gjilan, me numër personal ....., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse më datë 19.10.2023, në banesën e tij në rrugën "Iliria", në Gjilan, pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit elektrik, nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se, i pandehuri Parim Hoxha, si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, dhe në këtë mënyrë ka bërë harxhimin e paautorizuar të energjisë elektrike, me çka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar të dëmtuarën KEDS- distrikti ne Gjilan, në vlerë prej 668.09 €uro.

-me çka ka kryer veprën penale, **Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.**

Prandaj, në bazë të nenit 4,31,38,40,43,të KPRK-ës si dhe të nenit 495 par. 1.1 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

### **DENIM ME GJOBË**

Ashtu që i akuzuari dënohet me dënim me gjobë në shumë prej nga **100 (njëqind euro)**€,të cilin dënim është e obliguar që ta paguajnë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

E dëmtuara KEDS- Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **A r s y e t i m**

**Prokuroria Themelore në Gjilan**, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP.II.nr. 794/2024 të datës 07.06.2024, ndaj të akuzuarit ....., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe njëherësh gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me besueshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se e akuzuara vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykuese me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform nenit 495, par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, dhe vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv.

Kjo gjykatë, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si vijon janë bazë për dhënien e urdhrin ndëshkimor: Kallëzimi penal me nr. CMS-K-DGL-88, i datës 10.05.2024, procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike në terren me numër 2114034 i datës 19.10.2023, fotografi mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale, fatura nga kalkulimi i RH me Nr.493648 të datës 08.11.2023, dhe pro- fatura mbi dëmin e shkaktuar DGLHP2313745 e datës 08.11.2024.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 495 paragrafi 1,2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.333/2024 me datë 25.06.2024**

**Gjyqtari**  
Veli Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të paraqes kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.